

Me rastin e Ditës Botërore të Librit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, si dhe studentë të degëve të ndryshme organizuan një aktivitet me temë: "Një faqe më shumë, një horizont më i gjerë."

Ky aktivitet pati si qëllim të nxisë dashurinë për leximin, të promovojë rëndësinë e librit në formimin akademik dhe personal të studentëve, si dhe të krijojë hapësirë për reflektim mbi rolin e dijes në jetën e njeriut. Përmes këtij aktiviteti u synua të inkurajohet lidhja mes të rinjve dhe botës së librit në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese, duke e parë librin si një urë që bashkon mendimin, imagjinatën dhe dijen.

Aktiviteti u shoqërua me diskutime, interpretime krijuese dhe pjesë nga veprat e figurave të shquara të letërsisë shqipe dhe asaj botërore, të cilat përcjellin mesazhe frymëzuese për rëndësinë e librit.

